

VENDIM
Nr.36, datë 21.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,	
Hilmi Dakli,	Anëtar i	“““
Manol Konomi,	Anëtar i	“““
Veli Budo,	Anëtar i	“““
Franc Jakova	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Ha1il Kopani,	Anëtar i	“““
Zija Vuci,	Anëtar i	“““

me sekretare Drita Filto, më datën 10.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.33 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: PARTIA SOCIALDEMOKRATE, e përfaqësuar nga Av.Kleanthi Koci, me autorizim

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.1238, datë 6.7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zonën e ektorale nr.75.

GJYKATA KUSHTETUESE: pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin datë 30.6.1997 komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.75 Lushnjë, ka vendosur që në zgjedhjet e zhvilluara në 29 qershor 1997 për Kuvendin Popullor, të quaj të zgjedhur deputet në këtë zonë, kandidatin për deputet të Partisë Demokratike, Z.Sami Seit Sharka.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin e tij nr.1238, datë 6.7.1997 e ka lënë në fuqi vendimin e sipërm të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.75.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka rezultuar se procesverbali i hartuar nga komisioni i zgjedhjeve të kësaj zone është plotësuar me hamendje dhe përmban shifra të rumbullakosura. Ky komision në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar nuk i është referuar procesverbaleve të të gjitha qendrave të votimit të kësaj zone. Një fakt i tillë rezultoi i provuar me shpjegimet që dhanë përpara kësaj Gjykate të tre anëtarët e kryesisë së këtij komisioni. Ata thanë se gjatë përpunimit të të dhënave të procesverbaleve të qendrave të votimit, kanë hyrë në sallën e komisionit, persona të pidentifikuar, të cilët iu kanë marrë me forcë dhe kanë grisur pjesën më të madhe të këtyre procesverbaleve, me përjashtim të 6 copëve që këto më vonë i janë dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këtë gjendje të provave, Gjykata arrin në përfundim se ky procesverbal i komisionit të zgjedhjeve të kësaj zone, nuk pasqyron realitetin dhe si i tillë duhet të deklarohet i pavlefshëm.

Në vend të tij duhet të merren për bazë procesverbalet e qendrave të votimit që janë paraqitur si prova nga pala kërkuese. Nga kqyrja e tyre rezulton se ato janë plotësuar, nënshkruar dhe vulosur në rregull, sipas të gjitha kërkesave të ligjit mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor.

Prandaj Gjykata, duke iu referuar përmbajtjes së tyre dhe duke marrë vetë përsipër nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.75, si dhe duke përlogaritur një për një të dhënat që përmbajnë të gjitha këto procesverbale del me konkluzionin se fitues është kandidati për deputet i Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Socialiste, Z.Haxhi Esat Aliko. Ky në këtë zonë, nga 13378 (trembëdhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) vota të vlefshme gjithsej ka marrë 9697 (nëntëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) vota ose 72.5 % të tyre, kundrejt 2014 (dymijë e katërmëdhjetë) votave ose 15.1 % që ka marrë kandidati i Partisë Demokratike Z.Sami Seit Sharka.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 24 pika 7 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit datë 30. 6.1997 të komisionit të zgjedhjeve të-zonës nr.75 Lushnjë si edhe vendimit datë 6 7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpall të zgjedhur deputet për në Kuvendin Popullor në atë zonë, kandidatin e Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Socialiste, Z.Haxhi Esat Aliko.

Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Komisionit të Mandateve të Kuvendit të Ri Popullor .

Ky vendim është i formës së prerë.

Tiranë, me 21.7.1997